



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.203, datë 18.06.2021

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në kërkesën për dorëheqje nga detyra të z. Granit Shahu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 1276 prot, datë 10.06.2021, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje për **Z. Granit Shahu**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Dorëheqja jep efekt me datë 31.07.2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim Z. Granit Shahu, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GËNT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
TARTAR BAZAJ